

URDHËR
Nr.496, datë 4.7.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E FONDIT TË NGURTËSIMIT PËR GARANCINË E
FITUESIT/FITUESVE NË LOJËRAT E FATIT**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, të ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.238, datë 13.4.2001 “Për kriteret e dhënies së lejes për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, të ndryshuar

URDHËROJ:

Organizatorët e lojërave të fatit, për garantimin e fituesit/fituesve të lojërave të fatit, duhet të ngurtësojnë në një llogari të veçantë bankare, një shumë të caktuar si më poshtë vijon:

1. Për lojërat aritmetike

a) Për Bingo, fondi i ngurtësimit për shoqërinë të përcaktohet sipas kategorizimit të qyteteve:

- Për qytetet e kategorisë së I-rë (Tiranë dhe Durrës), fondi i ngurtësimit të jetë në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë.

- Për qytetet e kategorisë së II-të (Shkodër, Korçë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Elbasan, Fier, Lushnjë, Pogradec, Berat dhe Kavajë), fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

- Për qytetet e kategorisë së III-të (të gjitha qytetet e tjera), fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 000 000 (një milion) lekë.

- Për çdo filial dhe sallë të hapur në territorin e Republikës së Shqipërisë, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 000 000 (një milion) lekë.

b) Për Keno, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

c) Për lojërat aritmetike, që zhvillohen për pjesëmarrës jashtë sallave, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

2. Për lojërat e fatit sportive

a) Kategoria “Basti”, organizatori të garantojë për çdo lojë fituesin/fituesit e lojërave të fatit, me kapitalin themeltar të shoqërisë, si dhe me fondin e ngurtësimit në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

b) Kategoria “Konkurs për parashikimet sportive”, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 000 000 (një milion) lekë.

3. Për lotaritë

a) Lotari me shorte, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

b) Lotari të çastit, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë për çdo lotari (leje) të organizuar. Ky fond do të çngurtësohet vetëm pas përfundimit të çdo lotarie (loje).

4. Lojërat elektronike, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo makinë elektronike, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Licencave dhe e Menaxhimit të Kontratave, Sektori i Lojërave të Fatit.

Urdhri nr.151, datë 6.3.2007 shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli**